

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
KOMUNËN KASHAR TIRANË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Komunën Kashar, Tiranë**, me objekt: “*Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë*”, lloji i auditimit: “*Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare*”, për periudhën e veprimtarisë 01.07.2011 deri 30.06.2014 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 130, datë 24.09.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “*Për Kontrollin e Lartë të Shtetit*”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 591/11, datë 24.09.2014, i ka rekomanduar z. Besnik Fucia, Kryetar i Komunës Kashar, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetjet nga auditimi: Nuk janë marrë masa për implementimin e kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”; Është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik por nuk ka funksionuar, titullari i komunës, nuk ka caktuar koordinatorin e riskut dhe nuk janë evidentuar risqet dhe masat për menaxhimin e tij, nuk janë përcaktuar rregulla për administrimin dhe ruajtjen e aktiveve të qëndrueshme sipas kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

1.1.Rekomandimi: Kryetari i Komunës Kashar; të nxjerr urdhër për emërimin e koordinatorit të riskut dhe për ngritjen e grupit të punës për përcaktimin e rregullave mbi administrimin dhe ruajtjen e aktiveve të qëndrueshme, të marrë masa për funksionimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik.

Brenda datës 30.11.2014

2.Gjetjet nga auditimi: Konstatohet se për periudhën e auditimit, janë programuar buxhete jo realë dhe të pa balancuar. Në vitin 2011, buxheti në total është realizuar 60%, në vitin 2012, është realizuar 56% dhe në vitin 2013 realizuar 55%.

2.1.Rekomandimi: Komuna Kashar, të marrë masat e nevojshme për programimin e buxhetit të viti 2015 sa më real e të balancuar, nëpërmjet rritjes së bashkëpunimit më të mirë me zyrën e Financës, zyrën e Tatim Taksave dhe zyrën e Shërbimeve Publike.

Menjëherë

3.Gjetjet nga auditimi: Zyra e Ndhimave Ekonomike, ka trajtuar me ndihma ekonomike familjet në nevojë por listat emërore, nuk janë konfirmuar nga Zyra e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës të komunës Kashar; nëse kanë përfituar ose jo pronësi mbi tokën sipas ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 “*Për tokën*”, i ndryshuar dhe për bonitetin e saj, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005 “*Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore*”, i ndryshuar.

3.1.Rekomandimi: Zyra e Ndhimave Ekonomike, të marrë masa dhe të ndërpresë praktikën e dhënies së ndihmave ekonomike, pa konfirmuar më parë listat emërore të familjeve përfitues, nga Zyra e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës të Komunës Kashar.

Vazhdimisht

4.Gjetjet nga auditimi: Zyra e Taksave e Tarifave Vendore, nuk ka kryer kontrolle në subjektet tatim taksa pages; mbi lëshimin ose jo të kuponëve tatimore, mbi mbajtjen e

librave të xhiros etj., në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Përbashkët të Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë Financave nr. 655/1, datë 06.02.2007 “Për përcaktimin e uniformitetit të standardeve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksave vendore”, pika 10,

4.1.Rekomandimi: Zyra e Taksave e Tarifave Vendore, të marrë masa për hartimin e planit vjetor të kontrolleve në drejtimet e përcaktuara sipas kërkesave të Udhëzimit të Përbashkët të Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë Financave nr. 655/1, datë 06.02.2007, në bashkëpunim me Policinë e Komunës.

Brenda datës 30.11.2014

5 .Gjetjet nga auditimi: Konstatohet se për vitet 2011 dhe 2012, kanë ushtrua aktivitet pa qenë të regjistruar, gjithsej 304 subjekte taksa pagues. Mos regjistrimi i këtyre subjekteve në QKR, ka sjellë mos llogaritjen dhe arkëtimin e detyrimeve për kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore llogaritur në vlerën 20,023,872 lekë, shkelje e kërkesave të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, i ndryshuar neni 40 dhe 41, ligjit nr. 9136, datë 11.09. 2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore”, i ndryshuar.

5.1.Rekomandimi: Zyra e Taksave e Tarifave Vendore, në bashkëpunim me Policinë e komunës, të marrë masa dhe të ndjekë hapat e nevojshme ligjore për arkëtimin e detyrimeve të kontributeve për Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore në vlerën **20,023,872 lekë**, nga 304 subjekte që kanë ushtruar aktivitet të pa licencuar.

Brenda muajit 31 .03. 2015

6 .Gjetjet nga auditimi: Konstatohet se deri më datën 30.6.2014, nuk është arkëtuar vlera **82,561,000 lekë**, për 4 lloje taksa e tarifa të popullatës përkatësisht; taksa për ndërtesën, në vlerën 27,910,739 lekë, tarifa e pastrimit për vlerën 33,290,750 lekë, taksë ndriçimi për vlerën 7,988,800 lekë dhe taksë për infrastrukturën rrugore në vlerën 13,370,700 lekë.

6.1.Rekomandimi: Zyra e Taksave e Tarifave Vendore, në bashkëpunim me zyrën e Financës dhe Policinë e komunës, të marrin masat dhe të ndjekë hapat ligjorë administrativë për arkëtimin nga debitorët të vlerës 82,561,000 lekë nga taksat dhe tarifat e popullsisë.

Brenda datës 31.3.2015

7. Gjetjet nga auditimi: Zyra e Taksave Vendore, nuk ka proceduar sipas kërkesave ligjore për arkëtimin nga subjekte të biznesit të vogël dhe biznesit të madh të vlerës debitorë për 61,008,000 lekë dhe arkëtimin e gjobës në masën 25 për qind të detyrimit të pa paguar, në vlerën 3,687,308 lekë, gjithsej **64,695,308 lekë**, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedimin tatimor”, i ndryshuar, nenet 93, 114.

7.1.Rekomandimi: Zyra e Taksave Vendore, në bashkëpunim me zyrën e Financës dhe Policinë e komunës të marrë masa dhe të ndjekë hapat ligjorë administrativë për arkëtimin nga subjektet taksa pagues, të detyrimeve debitorë dhe vlerës së gjobës, gjithësej 64,695,308 lekë.

Brenda datës 31.3.2015

8. Gjetjet nga auditimi: Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor, ka marrë vendime pezullimi, vendosje gjobash si dhe 127 vendime për prishje të objekteve pa leje ndërtimi, të gjitha rastet e konstatuara janë shkelje e kërkesave të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për Planifikimin e Territorit” i ndryshuar.

8.1.Rekomandimi: Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor, pranë komunës Kashar, në bashkëpunim me Policinë e komunës, të marrë masat dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për prishjen e ndërtimeve pa leje.

Vazhdimisht

9. Gjetjet nga auditimi: Zyra e Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor, nuk ka raste të procedimit me kallëzim penal ndaj subjekteve që kanë ndërtuar pa leje, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit” i ndryshuar, neni 5 dhe ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit” i ndryshuar, pika 3, neni 83.

9.1.Rekomandimi: Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor në bashkëpunim me zyrën Juridike, të marrë masat dhe të procedojë me kallëzim penal ndaj subjekteve që ndërtojnë pa leje.

Vazhdimisht

10. Gjetjet nga auditimi: Nuk është proceduar në rrugë gjyqësore për vjeljen e detyrimeve nga gjobat, kamat vonesat dhe debitorë të tjerë në shumën **62,302,117 lekë** nga të cilat: 51,970,000 lekë për 75 gjoba dhe kamat vonesat e tyre të vendosura nga INUV, 74,540 lekë për 28 gjoba dhe kamat vonesat e tyre të vendosura nga Policia e Komunës. 10,257,577 lekë për 126 subjekte detyrime debitorë të krijuar në vite e të pasqyruara në bilanc, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative" neni 22, 30, 44.

10.1.Rekomandimi: Zyra Juridike, në bashkëpunim me Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor, zyrën e Financës dhe Policinë e Komunës, të marrë masat dhe të procedojë në rrugë gjyqësore, për vjeljen e detyrimeve debitorë, gjobat dhe kamat vonesat e tyre të vendosura nga INUV dhe policia e komunës.

Vazhdimisht

11. Gjetjet nga auditimi: U konstatua se me VKM nr. 645, datë 31.7.2013 “Për miratimin e listës paraprake të pronave të pa luajtshme publike shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Kashar të Qarkut Tiranë” dhe VKM nr.694, datë 21.5.2008 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, Komuna Kashar, të Qarkut të Tiranës", janë miratuar në administrim dhe në pronësi të komunës Kashar, prona përfshi pyje dhe kullota.

Këto prona, nuk janë marrë në dorëzim me procesverbal të shoqëruara me hartën përkatëse, në kundërshtim me VKM nr. 804, datë 4.6.2008, mbi: “Dorëzimin e fondit pyjor dhe kullor” si dhe nuk janë regjistruar në ZVRPP.

11.1.Rekomandimi: Kryetari i komunës Kashar, të krijojë komision për marrjen në dorëzim me procesverbal, pronat që me vendim të Këshillit të Ministrave, kanë kalur në pronësi të komunës duke verifikuar statusin e tyre në terren dhe më pas të procedohet për rregjistrimin e tyre në ZVRPP.

Brenda datës 31.12.2014

12. Gjetjet nga auditimi: Komuna Kashar, ka financuar projekte me karakter social, për stimulimin e bujqësisë për fermerët me të ardhura të vogla, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar, kap. I, neni 3, kap. III, neni 7 dhe ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, kreu II, neni 4 dhe neni 6, pika 2

12.1.Rekomandimi: Komuna Kashar, të marrë masat që projektet për financimin e zhvillimit bujqësor, të implementohen nëpërmjet Agjencisë së Zhvillimit Bujqësor Rural (AZHBR).

Menjëherë

13. Gjetjet nga auditimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit të komunës, nuk ka krijuar dhe azhurnuar Rregjistrin e Planifikimit të Territorit i cili shërben për të ruajtur, mirëmbajtur, administruar dhe përditësuar në mënyrë të pavarur të dhënat si: kërkesat për zhvillim, lejet e zhvillimit dhe ndërtimit, projektaktet dhe aktet e planifikimit, lejet e përdorimit, të dhënat për zhvillimin tokës etj., në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimi e territorit” i ndryshuar, kreu V, dhe VKM nr. 460, datë 16.06.2010 “Për organizimin dhe funksionimin e regjistrit të planifikimit të territorit”.

13.1.Rekomandimi: *Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit të komunës, të marrë masa dhe të krijojë Rregjistrin e Planifikimit të Territorit.*

Brenda datës 31.12.2014

14. Gjetjet nga auditimi: Në inventarizimin e kryer në shkollat e komunës në vitin 2013, janë konstatuar vlera inventariale të furnizuara nga Drejtoria Arsimore Rajonale Qarkut Tiranë të cilat nuk janë shoqëruar me dokumentacionin përkatës për lloin, sasinë, cmimin dhe të pa rakorduara me Zyrën e Financës të komunës Kashar, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kap. III, pikat 42, 43, 54, 55, 56 dhe 57.

14.1.Rekomandimi: *Zyra e Financës së komunës, të marrë masat dhe të rakordojë me Drejtorinë Arsimore Rajonale Qarkut Tiranë për furnizimet me bazë materiale të shkollave të Komunës gjatë vitit 2013 dhe në vazhdimësi.*

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Nga Komuna Kashar, të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore e përmbarimore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim për shpërblimin e dëmit me **vlerën 15,090,868 lekë**, në mënyrë analitike si më poshtë:

1. Gjetjet nga auditimi: Janë lidhur 27 kontrata dhënie me qera të amjenteve publike për qëllime banimi dhe nuk janë paguar detyrimet kontaktuale ndaj komunës Kashar për vlerën 5,823,783 lekë, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar neni 850.

1.1.Rekomandimi: *Për vlerën 5,823,783 lekë, sipas kontratave të lidhura me 27 personat fizikë, për sa nuk kanë paguar detyrimet kontraktuale.*

Brenda datës 31.12.2014

2. Gjetjet nga auditimi: Nuk është llogaritur dhe paguar kamat vonesë për taksën e lejes së ndërtimit për 4 subjekte në vlerën 3,072,873 lekë, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8405, datë 19.09.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar me ligjin nr. 10078, datë 16.2.2009, neni 9.

2.1.Rekomandimi: *Për vlerën 3,072,873 lekë, për sa nuk është llogaritur dhe paguar kamat vonesë për 4 subjekte.*

Brenda datës 31.12.2014

3. Gjetjet nga auditimi: Është paguar për vlerën 1,951,182 lekë, subjekti “S...” shpk, për volume pune të pa kryera në objektin: “Ndërtim rrjeti shpërndarës Ujësjellësi Fshati Yrshek”, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8402, datë 1.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, neni 7 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", pika 17.

3.1.Rekomandimi: Për vlerën **1,951,182 lekë**, për sa është paguar subjekti “S...” shpk për volume pune të pa kryera në objektin: “Ndërtim rrjeti shpërndarës Ujësjiellësi Fshati Yrshek”.

Brenda datës 31.12.2014

4. Gjetjet nga auditimi: U konstatua se për 6 subjekte ndërtimore, është llogaritur dhe paguar më pak taksa e ndikimit në infrastrukturë për vlerën 1,442,174 lekë, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8405, datë 19.09.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar, neni 51, VKM nr. 502, datë 13.07.2011 “Për miratimin e rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit”, ndryshuar dhe UKM nr. 4, datë 23.11.2011 “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit”.

4.1.Rekomandimi: Për vlerën **1,442,174 lekë**, për sa kanë paguar më pak taksën e ndikimit në infrastrukturë, 6 subjekte.

Brenda datës 31.12.2014

5. Gjetjet nga auditimi: Është paguar për vlerën 1,182,792 lekë bashkimi i operatorëve ekonomik “B...” dhe “E...” shpk për volume pune të pa kryera në objektin: “Rikonstruksion i rrugës Ali Pashë Gucia, Fshati Katund i Ri”, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8402, datë 1.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 17.

5.1.Rekomandimi: Për vlerën **1,182,792 lekë**, për sa është paguar bashkimi i operatorëve ekonomik “B...” dhe “E...” shpk për volume pune të pa kryera në objektin: “Rikonstruksion i rrugës Ali Pashë Gucia, Fshati Katund i Ri”.

Brenda muajit dhjetor 2014

6. Gjetjet nga auditimi: Komuna Kashar, ka furnizuar me karburant drejtuesit e tre shkollave për kalidajet e ngrohjes në vlerën 1,073,646 lekë. Për përdorimin e karburantit, mungon dokumentacioni i nevojshëm justifikues, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kap. III, pikat 35/b, 36;

6.1.Rekomandimi: Për vlerën **1,073,646 lekë**, për sa janë furnizuar me karburant drejtuesit e shkollave të komunës dhe nuk kanë dokumentuar përdorimin e tij: R.K. për 682,708 lekë; M.S. për 271,848 lekë dhe A.G. për 119,090 lekë.

Brenda datës 31.12.2014

7. Gjetjet nga auditimi: Është paguar për vlerën 453,127 lekë subjekti: “A...” shpk për volume pune të pa kryera në objektin: “Sistemim (me çakull), Kanalizime në bllokun e rrugëve në zonën 235.5 ha, Komuna Kashar”, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8402, datë 1.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 17.

7.1.Rekomandimi: Për vlerën **453,127 lekë**, për sa është paguar subjekti “A...” shpk për volume pune të pa kryera në objektin: “Sistemim (me çakull), Kanalizime në bllokun e rrugëve në zonën 235.5 ha, Komuna Kashar”.

Menjëherë

8. Gjetjet nga auditimi: Me urdhër shpenzimin nr. 307, datë 2.10.2012, është paguar subjekti: “Kupa” për vlerën 91,291 lekë, më tepër se vlera e kontratës nr. 2037/5 datë 19.12.2011, me objekt: “Blerje materiale ndërtimi”, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kap. III.

8.1.Rekomandimi: Për vlerën **91,291 lekë**, përse është paguar subjekti: “K...” shpk më tepër se vlera e kontratës.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

-Mbështetur në kreun IV, neni 11, germa “e” dhe “ç” dhe nenin 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, i rekomandojmë Kryetarit të Komunës, fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore:

“Ndërprerje të marrëdhënieve të punës”, për:

1. z. L.S., me detyrë Specialist në zyrën e shërbimeve.

-Për mos evidentimin si aktivitet më vehte, të shpenzimeve dhe të ardhurave nga Ujësjiellësi i Komunës si dhe mos evidentimi i detyrimeve debitore të abonentëve të ujit të pijshëm, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabël”, kap. I dhe ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore” i ndryshuar neni 8, paragrafi I/c dhe neni 19, pika 6.

-Për mangësi në dokumentacionin për evidentimin e konsumit të karburantit, në mjetet e transportit dhe në kaldajat e shkollës ku është evidentuar me dëm ekonomik në shumën 1,073,646 lekë, në kundërshtim me kërkesat e të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kap. III, pikat 35/b, 36

Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”, për:

1. z. K.K., me detyrë Kryeinspektor i Inspektoriatit Ndërtimor Urbanistik të Komunës.

-Për mos vendosjen e masës së gjobës llogaritur në vlerën 8,300,000 lekë për kundërvajtjet e konstatuara ndaj subjekteve ndërtimore, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar, nenet 57, 81 dhe ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit” i ndryshuar, nenet 82, pikat 6, 8.

-Për mos ndjekjen e procedurave ligjore për arkëtimin e 75 rasteve gjoba të vendosura nga Inspektoriatit Ndërtimor Urbanistik Vendor, në vlerën 32,650,000 lekë, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, neni 16 dhe ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” neni 22, 30, 44.

2. zj. M.Sh., me detyrë Juriste e zyrës së Planifikimit, Kontrollit të Zhvillimit të Territorit dhe Rregjistrimit Elektronik.

-Për shkelje të kërkesave të ligjit nr. 8405 datë 17.09.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar, neni 45 në lejet e ndërtimit të miratuara me vendim të KRRT-së nr. 2, datë 28.9.2011 dhe nr. 3, datë 29.09.2011.

3. z. H.Sh., me detyrë Përgjegjës i Zyrës së Tatimit Taksave,

-Për mos zbatim të procedure ligjore për vjeljen e tatimit taksave lokale, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 93, pika 1 dhe neni 114.

4. zj. V.P., me detyrë Përgjegjëse e sekretarisë teknike.

-Për mos përlllogaritur saktë të sipërfaqeve ndërtimore të objekteve me pasojë arkëtuar më pak taksë për lejet e ndërtimit për 2,928,460 lekë me dëm ekonomik, në kundërshtim me

kërkesat e ligjit nr. nr. 8405, datë 19.09.1998 “Për urbanistikën”, të ndryshuar, neni 51 dhe VKM nr. 502, datë 13.07.2011 “Për miratimin e rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit” ndryshuar, pika 8, neni 14, UKM nr. 4, datë 23.11.2011 “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2011” dhe UKM nr. 1, datë 8.5.2013 “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2013”

5. z. J.M., me detyrë Përgjegjëse i zyrës së urbanistikës.

-Për mos përlogaritur saktë të sipërfaqeve ndërtimore të objekteve me pasojë arkëtuar më pak taksë për lejet e ndërtimit për 2,928,460 lekë me dëm ekonomik, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. nr. 8405, datë 19.09.1998 “Për urbanistikën”, të ndryshuar, neni 51 dhe VKM nr. 502, datë 13.07.2011 “Për miratimin e rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit” ndryshuar, pika 8, neni 14, UKM nr. 4, datë 23.11.2011 “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2011” dhe UKM nr. 1, datë 8.5.2013 “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2013”

-Për shkelje të kërkesave të ligjit nr. 8405 datë 17.09.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar, neni 45 në lejet e ndërtimit të miratuara me vendim të KRRT-së nr. 2, datë 28.9.2011 dhe nr. 3, datë 29.09.2011.

-Për mos përgatitjen reportin vjetor për zhvillimet e territorit, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit” i ndryshuar, nebni 80, pika 3.

-Autoriteti Kontraktor, të vlerësojë shkallën e shkeljeve ligjore dhe shkallën e përgjegjësisë për Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe Anëtarët e Njesisë së Prokurimit, në procedurat e prokurimit të fondeve publike të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe të marrë masat disiplinore përkatëse.

Për Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave: Kryetar- P.Ll. dhe anëtarët; E. I., U. O., B.K., M.Sh., J.M., P.F. dhe B.A.

Për Njësinë e Prokurimit: Juriste- I.B. dhe anëtarët; J.A., M.Sh., R.I., I.A., A.T., U.O. dhe A.I.

D. MASA ADMINISTRATIVE

Mbështetur në ligjin nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, nenet 9 dhe 16 dhe VKM nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike,që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ndryshuar me VKM nr. 92, date 19.02.2014, Kreu VII, “Sanksione”, pika 1, shkronja (a), i rekomandojmë Komisionit të Dhënies së Liçencave, pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastruktures, që për shkelje të ligjshmërisë në ndërtim të vendosë sanksionet si më poshtë:

- Heqjen e Liçencës, për një afat prej 2 (dy) vjet, të mbikëqyrësit të punimeve të ndërtimit, respektivisht:

1.znj. F.V., (liçenca me nr. MK 1706/2), me të cilën është lidhur kontrata e shërbimit me nr. 413/6, datë 04.07.2011, për shkak se:

Në objektin: “Ndërtim Rrjeti Shpërndarës ujsjellësi Fshati Yrshek”, me sipërmarrës subjektin: “S...” shpk, punimet e ndërtimit nuk janë zbatuar në përputhje me kushtet teknike të projektimit e të zbatimit dhe librezat e masave për përshkrimin e punimeve sipas grafikut

dhe projekt zbatimit, nuk pasqyron me vërtetësi punimet e kryera për të përcaktuar saktë volumet e punimeve. Në zbatim, u konstatuan punime të pa kryera për vlerën 1,951,182 lekë përfituar padrejtësisht subjekti "S..." shpk.

Sa më sipër është në kundërshtim me nenin 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar dhe me Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 "Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit", të ndryshuar. Me hollësisht problemet janë trajtuar në procesverbalin nr. 12 datë 30.7.2014.

2. Shoqërisë mbikëqyrëse "Gjeokonsult & Co" me nr. licence MK 1735/2 përfaqësuar nga administratori z. H.M., me ing. R.K. dhe ing. Xh.D., për shkak se:

Në objektin: "Rikonstrukcion i rrugës Ali Pashë Gucia, Fshati Katund i Ri", me sipërmarrës subjektin: Bashkimit të operatorëve ekonomik "B..." shpk dhe "E..." shpk, punimet e ndërtimit nuk janë zbatuar në përputhje me kushtet teknike të projektimit e të zbatimit, Në zbatim, u konstatuan punime të pa kryera për vlerën 1,182,795 lekë përfituar padrejtësisht subjekti: të operatorëve ekonomik "B..." shpk dhe "E..." shpk.

Sa më sipër, është në kundërshtim me nenin 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar dhe me Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 "Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit", të ndryshuar. Me hollësisht problemet janë trajtuar në procesverbalin nr. 7, datë 29.7.2014.

Nga Komuna Kashar, Tiranë me shkresë nr. 1840/4, prot, datë 13.10.2014, protokolluar në KLSH me nr.591/14 datë 14.10.2014, është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë pranuar dhe zbatuar pjesërisht.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit Josif Lile, Përparim Gjuzi, Julian Adili, Dorino Mece, Pal Daci, Luan Kuka dhe Jonild Hoxhaj më tej u shqyrtua nga z. Selfo Zeneli kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, Kontrollit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Helga Vukaj, Drejtor i Përgjithshëm.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT